



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T I

Nga procesverbali i mbledhjes së 29-të të jashtëzakonshme, të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 24.04.2024, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Shefki Bytyqi, anëtar
4. Gazmend Qerkini, anëtar
5. Shkelzim Olluri, anëtar
6. Albiona Tasholli, anëtare
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Sami Bytyqi, anëtar
9. Fitim Shala, anëtar
10. Xhyzide Rustemi, anëtare
11. Rinor Murati, anëtar
12. Armend Grajqevci, anëtar
13. Gentianë Hoxhaj, anëtare
14. Venhar Agushi, anëtar
15. Xhyla Dedushaj, anëtare
16. Lulzim Rustemi, anëtar
17. Herolind Kozhani, anëtar
18. Ardit Cani, anëtar
19. Arsim Jashari, anëtar
20. Egzona Bytyqi, anëtare
21. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
22. Ganimete Qeriqi, anëtare
23. Alban Salihu, anëtar
24. Fitim Meziu, anëtar
25. Fadil Spahiu, anëtar
26. Fatmir Fetahu, anëtar
27. Shahadije Dragaçina, anëtare
28. Besiana Sylja, anëtare
29. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, kryetar i komunës
2. Diamnt Bytyqi, nënkryetar i komunës
3. Lulzim Rrustemi, nënkryetar i komunës
4. Latif Ramadani DBF
5. Valon Pacolli, DEZH
6. Shkelzen Hajdini, DSH
7. Elmaze Behluli, DA
8. Sead Aliu, DI
9. Rexhep Rexhepi, DBP
10. Rasim Hasani, DA
11. Safete Amerrlahu, DGJK
12. Burim Rrustemi, DSHPMSH
13. Imri Semetishti, DUPMM
14. Anila Reqica-LLugiqi, DKRS
15. Flamur Sylejmani, DI
16. Përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit, tha se ju uroj qe jeni mirë dhe po kaloni mirë, po ashtu tha se me kerkese te kryetarit te komunës kemi thirre mbledhje te jashtëzakonshme.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë me kohë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE**I****Propozim Vendim për rritjen e buxhetit të komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake per vitin 2023**

Pastaj Kryesuesi e hodhi ne votim rendin e ditë së propozuar dhe pas votimit u konstatua se me 25 vota per u aprovua rendi ditës.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadani, drejtor i DBF i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Gazmend Qerkini, tha se konsideroj qe është një rezultat i jashtëzakonshëm dhe është një rezultat i menaxhimit te mire te organeve komunale dhe i falënderoj edhe qytetarët për kontributin e tyre. Se me te vërtete arritjet e tilla janë te mire për komunën tonë.

Alban Salihu, tha se natyrisht e vlerësojmë larte gatishmërinë e qytetarëve te komune s se Lipjanit qe janë treguar te përgjegjshëm ndaj obligimeve tatimore, përkundër faktit qe komuna e Lipjanit nuk e ka ndje ndjeshmërinë e nevojshme qe me ju bashkuar komunave qe ta falin tatimin ne pronë deri ne vlerën 100 euro. Fakti qe janë te përfshira ne këtë propozim dy stadiumet problematike ai i Dobrajes dhe Magures qe ne i konsiderojmë projekte me elemente te keqpërdorimit dhe ende drejtësia nuk e ka thënë fjalën e vet për ketë arsye ne do te abstenojmë ,por fakti qe po abstenojmë nuk do te thotë qe me ketë shpërndarje nuk janë te duhurat dhe te nevojshmet.

Besiana Sylja, tha se ne raportin e shpenzimeve dhe te hyrave Janar Dhjetor 2023,dhe është cek qe buxheti i komune është 24 milion, unë atë kohe e kam cek qe kjo shume nuk është e sakte sepse kemi tejkallim te të hyrave dhe në atë kohë. Kisha kërkuar kur te bëhen raportimet te jen te sakta. Pra tani buxheti i komunës nuk është 24 milion por mbi 25 milion pasi qe i shtohen këto te hyra, kemi një buxhet me te madh dhe kemi ndryshime. Te tejkallimi i buxhetit kemi një keq klasifikim sepse kemi te hyra mbi 50%.

Ardit Cani,tha se çdo projekt është i mirëseardhur për neve, mirëpo pse nuk është përfshirë asnjë projekt për fshatrat Bance, Risionvc dhe Mirenë. Kërkoj qe te këtë propozim qe hyje edhe trotuari ne fshatrat Bance dhe Resinvc.

Lulzim Rrustemi, tha se sa i përket këtij propozimi kemi një shifër te mire te rritjes se buxhetit dhe unë i falënderoj qytetarët për një përgjigje solide ndaj institucioneve. Janë 4 projekte te reja dhe te tjerat janë projekte qe vazhdojnë. Te projektet e reja nëse ka mundësi me u shtuar edhe trotuari ne Bance dhe te ndërtimi i urave do te ishte mire qe ura mbi lumin Gadime qe hyj edhe ajo ne projekt, përndryshe është mbështetje e mire për qytetarët.

Arsim Jashari, tha se së pari kemi një gabim teknik te totali i shumës, dhe te ndërtimi i shkollës se re a eshët borxh apo. Ne emër te grupit te PDK-së, e mbështesim këtë propozim dhe shpresojmë qe do te shkojnë ne vendin e duhur.

Rinor Murati, tha sa i përket këtij propozimi është për tu vlerësuar puna e ekzekutivit dhe në veçanti gatishmëria e qytetareve për ti paguar obligimet. Një gjë

për keqardhje që është, që këtë vit qytetaret do të ngarkohen edhe me tatimin e tokës bujqësore një barre për të cilën ka vendosur niveli qendror. Ndërsa sa i përket projekteve të reja është për tu përshëndetur finalizimi i dy stadimeve në Dobraje të Madhe dhe Mgaure.

Albiona Tasholli, tha se një propozim që meriton mbështetjen e të gjithë qytetarëve të komunës së Lipjanit, po ashtu tha se qytetaret e këtyre fshatrave duhet të shohin se kush nuk po i voton projektet e tyre e kush po i voton.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se i gëzohem faktit që në listë është edhe memoriali i UÇK-së, në Shalë, mirëpo unë kërkoj që komuna mos të kufizohet vetëm në këtë shumë por të ndaj edhe mjete tjera për një memorial aq madhështor.

Lulzim Rrustemi, tha se është mirë kur të behet asfaltimi i rrugicave të paktën të emërtohen aq sa ka mundësi pasi që qytetaret nuk po e dijnë se cilat rrugica do të asfaltohen.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se ju jepmi mirënjohje qytetarëve por kontributet e kryera. Këta të hyra kanë hyrë në saje të punës e ekzekutivit dhe nuk jam i lumtur që nuk kam mujt me të përfshi krejt fshatrat por nuk mundni me të shti krejt fshatrat, por jemi munduar që të fusin ato projekte ku janë më të rëndësishme. Sa i përket projektit në Shalë jam konsultuar me këshillin e fshatit. Dhe këtu nuk kemi bartje të të hyrave por kemi rritje të buxhetit, ndërsa bartjen do ta kemi në mbledhjen në vijim. Stadiumet do të bëhen natyrisht që në të kemi shkruar shkresë zyrtarë organeve të ndjekjes për këtë temë dhe në kemi marr përgjigjeje për këtë temë. Të ura në Gadime është në kompetencë të Ministrisë. Por do të provojmë me marr pëlqimin edhe në më rregullua edhe pse me herët i kemi zgjeruar me herët në ato ura. E dëgjova këtu dhe një gjë mos saktësia e të dhënave, është për tu çuditur se çfarë thuhet, por vetëm dikush nuk thua diçka të sekt një zero e thuhet gabim mund të ballafaqohet me drejtësinë dhe ju lus mos foli kot po keni parasysh se çka po flisni.

Besiana Sylja, tha se ato shifra nuk i kam qit vet, por kur janë ardh në kuvend ato shifra ju nuk keni qen në kuvend hiç. Dhe unë nuk i kam shpif ato shifra por janë në raport dhe është raportim i juaji dhe nuk është marr me gabua. Ju nuk i keni menaxhuar mirë të hyrat sepse keni mbi 50% dhe nuk i keni planifikuar mirë.

Alban Salihu, tha se nuk pajtohem me mënyrën se ju e shpenzoni buxhetin, dhe fakti pse nuk e votojmë nuk na qet kundër projekteve të qytetarëve, edhe LDK-ja, në nivel qendror e ka votuar buxhetin kundër. Na mendojmë që buxheti duhet me u shfrytëzua ndryshe. Stadiumi në Magure, nuk i plotëson kushtet ku as dimensionet

nuk janë me proporcion me kriteret e komisionit të sportit. Kur e keni nderuar fushën e tenisit nuk i keni ndërtuar fare rrjetet anësore për ndalje të topit.

Arsim Jashari, tha se pajtohen me Rinorin, për tatimin në toka bujqësore dhe është dashtë me na u jep një hapësirë që me u legalizua tokat pasi që shumica nga ne nuk kemi toka në emër tonin dhe do të hyjmë në tatim. Përndryshe do të kemi vështirosi dhe për here të pare do të tatohemi me tatim të pronës, pas disa viteve.

Imri Ahmeti, kryetari i komunës tha se tatimi në prone është i rregulluar me ligj, edhe tatimi për prona ka me pas probleme dhe komunat janë të pa përgatitur, por nuk varet nga ne, por nëse varen nga ne unë e hiçi krejt.

Nexhemdnin Lekiqi, tha se u kritikua se të hyrat vetanake hyrën nga keq menaxhimi. Por këtu po shihet në kundërta se të hyrat janë hyre nga punë që është bere dhe nga të hyrat nga ndërtimi dhe punët tjera të mira. Dhe këtu ka një program që në fund barazohet çdo cent i cili hyn dhe del. E fundit është mire që ne kemi ardh me diskutuar për rrjetet e mbrojtjes së topit të tenisit.

Lulzim Rrustemi, tha se unë kam propozim që të futet dhe trotuari në Bainsë.

Besiana Sylja, tha se të të tyre vetanake të tejkalimi, është keq planifikim se ki tejkalim të të hyrave mbi 50%.

Daut Azemi, tha përves të hyrave në tatimin në pronë ka edhe të hyra tjera që nuk e din askush e sa do të hyjnë.

Alban Salihu, tha se nuk është jo serioze ndërtimi i mbrojtësve të topit në fushën e tenisit por dikujt i duket.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se, buxheti, kur behet në nivel vendi korniza behet se sa ke të hyra ky shtet dhe specifikohet të gjitha garantët dhe caktohet tavani nga niveli qendror.

Megjë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 20 vota për, aprovoi propozimin

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 11:25.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi